



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN

Rr. Zija Shemsiu, p.n., 60000 Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel. +381 (0) 280390112

Vend nr. 02/2754 Datë 15/11 / 2024

Në mbështetje të nenit 17 parag. 3 të Statutit të Universitetit dhe nenit 22 parag.1 pika 2, të Rregullores mbi Punën e Këshillit të Drejtues në Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, Ref. nr. 02 / 2900 dt. 19.12.2023, bazuar në Vendimin nr. 02/1859 datë 12.09.2024 për shfuqizimin e Vendimit 02/219 dt.06.02.2023, si dhe pas shqyrtimit të kërkesës së datës 06.11.2024 të parashtruar nga Prof.Asoc.Dr. Dukagjin Leka, Këshilli Drejtues në mbledhjen e parë (-I-) të mbajtur më 06.11.2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa retroaktive e shpenzimeve të vogla (para xhepi) në masën 20% të shpenzimeve ditore, sipas Vendimit të Ministrisë së Financave nr. 30/2018, dt. 19.06.2018, Shtojca A, Kolona D.
2. Pagesa nga pika 1 e këtij vendimi zbatohet vetëm për stafin akademik dhe administrativ të përfshirë në projekte të financuara nga donatorët për periudhën 20.04.2022 deri më 05.09.2024.
3. Personeli i përfshirë është i detyruar të paraqesë kërkesën për pagesë retroaktive, të shoqëruar me dokumentacionin mbështetës të nevojshëm, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues.

A r s y e t i m

Me datën 06.11.2024 Prof.Asoc.Dr. Dukagjin Leka, ka parashtrua kërkesë, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të pambuluara - shpenzime të vogla (per diem/para xhepi), në masën 20% të mëditjes së plotë sipas Vendim të Ministrisë së financave nr. 30/2018 dt.19.06.2018, shtojca A, kolona D, për stafin akademik dhe administrativ të përfshirë në projekte të financuara nga donatorët. Kërkesa është mbështetur në Vendimin nr. 02/1859 datë 12.09.2024 për shfuqizimin e Vendimit 02/219 dt.06.02.2023, për pagesat në periudhën kohore për sa ka qenë

e pezulluar me Vendimin të Rektorit nr.01/690 datë 20.04.2022 dhe i miratuar nga Këshilli Drejtues me Vendimin 02/219 dt.06.02.2023

Përshkrimi i dokumentacionit të shqyrtuar

1. Vendimi i Ministrisë së Financave Nr.30/2018 dt.19.06.2018 për aplikimin e tarifave të rishikuar për udhëtime jashtë vendit Bashkangjitur këtij vendimi shtojca A dhe shtojca B.

Vendimi parasheh tarifën e rishikuar për udhëtimet jashtë vendit sipas listës bashkangjitur - Shtojca A, e cila përmban katër kolona të tarifave të shpenzimeve të përcaktuara për secilin shtet. Sipas kësaj shtojce:

- Kolona A parashikon tarifën për shpenzime ditore (fjetja, ushqimi, shpenzimet e vogla)
- Kolona B - shpenzimet e fjetjes
- Kolona C - shpenzimet e ushqimit
- Kolona D - shpenzim të vogla –para xhepi 20% të tarifës së shpenzimeve ditore.

Ndërsa, Shtojca B përmban sqarime lidhur me tabelën e udhëtimit jashtë vendit, e që ka paraparë se shpenzimet të vogla (para xhepi) në vlerën prej 20 % e tarifës së shpenzimeve ditore aplikohet vetëm në rastet kur shpenzimet ditore mbulohen nga donatorët. Tjetër, vendimi duke ju referuar përputhshmërisë me nenet 13,14,15 të UA 2004/7 të MSHP për Udhëtimet Zyrtare, ka përcaktuar se në rastin kur gjitha shpenzimet mbulohen nga donatori, por nuk përfshihen edhe shpenzimet e vogla (per diem/para xhepi), në këto raste zyrtari përfiton nga buxheti i organizatës së tij buxhetore mjetet financiare në vlerë prej 20 % të shpenzimeve ditore.

Bazuar në këtë sqarim nëse donatori ka mbuluar shpenzimet ditore, por nuk i ka siguruar zyrtarit paradhënie (avans) e as shpenzime të vogla-para xhepi, atëherë këto shpenzime do të duhej të mbulohen nga buxheti i Universitetit sipas kolonës D të shtojcës A të Vendimit të Ministrisë së Financave Nr.30/2018 dt.19.06.2018.

2. Vendimi i Rektorit nr.01/690 datë 20.04.2022, Miratuar nga Këshilli Drejtues me vendim nr. 02/219 dt.06.02.2023

Rektori me 20.04.2022 ka nxjerr vendim, i cili më pas me datën 06.02.2023 është miratuar nga Këshilli Drejtues, me të cilin janë pezulluar për një kohë të caktuar pagesa –mjete të imta (para xhepi) parashikuar në kolonën D, të shtojcës A në vendimin Nr. 30/2018 të dt.19.06.2018 të Ministrisë së Financave në rastet e projekteve të donatorëve.

Pika 2 e këtij vendimi ka paraparë pezullimin për kohë të caktuar, deri në marrjen e një vendimi tjetër ose përgatitjen e një rregullore që trajton këtë çështje.

3. Vendimi i Këshillit Drejtues 02/1859 datë 12.09.2024

Pas një shqyrtimi të plotë të situatës dhe duke marrë parasysh sqarimin e Ministrisë së Financave, lidhur me zbatimin e Vendimit të MF. Nr.30/2018 dt.19.06.2018, respektivisht Kolonës D të shtojcës A, Këshilli Drejtues ka shfuqizuar vendimin e datës 23.04.2023 për pezullimin e pagesave të shpenzimeve të vogla (para xhepi).

Përfundimi

Pas shqyrtimit të legjislacionit në fuqi të përmendur më lartë dhe me qëllim të sigurimit të zbatimit korrekt të politikave financiare dhe mbrojtjes së interesave të personelit akademik dhe administrativ, duke respektuar njëkohësisht parimet e ligjshmërisë dhe drejtësisë, Këshilli Drejtues, në mbështetje të autorizimeve ligjore të përcaktuara me Statutin e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiçan, vendosi në dispozitivin e këtij Vendimi.



Kryesuesi i KD-së
Dr. Techn. Ilir Gjinolli

Vendimi i dërgohet:

1. Palëve
2. Rektorit të UKZ-së
3. Sekretarit të Përgjithshëm
4. Divizionit për Buxhet e Financa